



Program për nivelin Master i Shkencave në " Ekonomi qarkulluese "

Programi i Masterit Shkencor në **Ekonomi Cirkulare** përfaqëson një ofertë akademike inovative dhe të orientuar drejt së ardhmes, e konceptuar për të siguruar një formim të avancuar teorik, analitik dhe praktik në fushën e ekonomisë së qëndrueshme, menaxhimit të burimeve dhe tranzicionit të gjelbër.

Programi është i lidhur ngushtë me sfidat aktuale të zhvillimit ekonomik në Shqipëri dhe me procesin e integritimit evropian, duke synuar përgatitjen e specialistëve të aftë për të analizuar, projektuar dhe zbatuar politika dhe modele ekonomike që mbështesin ekonominë qarkulluese.

Ai integron në mënyrë të balancuar:

- formimin teorik në ekonomi dhe mjedis,
- analizën e përdorimit të burimeve dhe dështimeve të tregut,
- instrumentet e politikave publike dhe të Bashkimit Evropian,
- financat e gjelbra dhe inovacionin,
- metodat moderne të analizës së të dhënave dhe vendimmarrjes.

Një komponent thelbësor i programit është dimensionin kërkimor, i cili realizohet përmes përgatitjes së tezës së Masterit, duke zhvilluar aftësitë analitike, kritike dhe metodologjike të studentëve në trajtimin e çështjeve komplekse të tranzicionit drejt ekonomisë së gjelbër.

Programi bazohet në një qasje ndërdisiplinare, duke integruar ekonominë, politikat publike, financat, mjedisin dhe teknologjinë, në përputhje me praktikën më të mira evropiane dhe strategjitë si **Green Deal** he **Circular Economy Action Plan**

Ndryshe nga programet tradicionale të studimit, Masteri i Shkencave në Ekonomi Qarkulluese ofron një qasje bashkëkohore dhe praktike duke:

- Trajtuar ekonominë si një instrument strategjik për zgjidhjen e sfidave mjedisore, të burimeve natyrore dhe të qëndrueshmërisë.
- Vendosur fokusin te reduktimi i mbetjeve, eficientia e burimeve, modelet qarkulluese të prodhimit dhe konsumi i qëndrueshëm.
- Integruar financën e gjelbër, inovacionin, transformimin digjital dhe sipërmarrjen e qëndrueshme.
- Përgatitur ekspertë të aftë për të mbështetur Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, proceset e integritimit në BE dhe tranzicionin e gjelbër të Shqipërisë.
- Zhvilluar kompetenca profesionale për identifikimin, projektimin dhe zbatimin e mundësive të reja të biznesit, të bazuara në parimet e ekonomisë qarkulluese.
- Nxitur studentët të shndërrojnë sfidat mjedisore në zgjidhje biznesi inovative, konkurruese dhe të qëndrueshme.
- Forcuar lidhjen ndërmjet zhvillimit ekonomik, përgjegjësisë mjedisore dhe ndikimit afatgjatë social.

Në tërësi, programi synon të formojë profesionistë dhe ekspertë të nivelit të lartë, të aftë për të kontribuar në transformimin e ekonomisë shqiptare drejt një modeli të qëndrueshëm dhe konkurrues.

Qëllimet kryesore të programit

Objektivat kryesore të programit janë:

- Të ofrojë një formim të avancuar në ekonominë qarkulluese dhe zhvillimin e qëndrueshëm
- Të zhvillojë kompetenca në analizën dhe vlerësimin e politikave mjedisore dhe ekonomike
- Të pajisë studentët me aftësi analitike për vlerësim ekonomik (kosto–përfitim, LCA, impact assessment)
- Të sigurojë njohuri mbi politikat dhe standardet e BE-së për tranzicionin e gjelbër
- Të zhvillojë kapacitete kërkimore dhe metodologjike
- Të nxisë qasjen ndërdisiplinare në analizën e ekonomisë dhe mjedisit
- Të përgatisë profesionistë të aftë për tregun e punës në ekonomi të gjelbër

Kompetencat kryesore të fituara

Studentët do të fitojnë:

- Njohuri të thelluara mbi ekonominë qarkulluese dhe përdorimin efikas të burimeve
- Aftësi për analizë dhe vlerësim të politikave publike mjedisore
- Kompetenca në analizën e të dhënave dhe metodologjitë kërkimore
- Njohuri mbi instrumentet financiare të gjelbra
- Aftësi për hartimin e projekteve dhe strategjive të qëndrueshme
- Kompetenca për analizë të zinxhirëve të vlerës dhe modeleve qarkulluese
- Aftësi për formulimin e politikave dhe rekomandimeve strategjike

Mundësi punësimi

Sipas analizës së tregut të punës, deri në vitin 2030 Shqipëria pritet të ketë nevojë për rreth 100–200 specialistë të kualifikuar në fushën e Ekonomisë Qarkulluese dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo kërkesë lidhet me nevojën në rritje për ekspertizë profesionale në:

- Ekonominë e gjelbër dhe modelet e qëndrueshme të biznesit;
- Menaxhimin eficient të burimeve natyrore dhe lëndëve të para;
- Reduktimin e mbetjeve, riciklimin dhe sistemet qarkulluese të prodhimit;
- Politikat mjedisore, përafrimin me Bashkimin Evropian dhe zbatimin e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane;
- Financën e gjelbër, sipërmarrjen e qëndrueshme dhe inovacionin;
- Zhvillimin rezilient ndaj ndryshimeve klimatike dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.
- Financa të qëndrueshme

Të diplomuarit mund të punojnë në:

Institucione publike

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Agjenci mjedisore dhe zhvillimore

Qeverisje vendore

- Bashki dhe struktura të zhvillimit lokal
- Projekte të ekonomisë së gjelbër

Sektori privat

- Kompani prodhuese dhe agro-ushqimore
- Konsulencë për qëndrueshmëri dhe ESG
- Industri riciklimi dhe energjie

Institucione financiare dhe projekte

- Banka dhe financa të gjelbra
- Projekte IPA, Green Agenda

Institucione akademike dhe ndërkombëtare

- Universitete dhe institute kërkimore
- Organizata si FAO, BE, UNDP, GIZ

Struktura e programit

Programi zhvillohet përgjatë **dy viteve akademike (4 semestra)** dhe përfshin **120 kredite ECTS**, duke siguruar një progresion të strukturuar nga formimi teorik drejt aplikimit praktik dhe kërkimit shkencor.

Viti i parë

Fokus në bazat teorike dhe metodologjike:

- Ekonomi e mjedisit dhe burimeve
- Politika për tranzicionin e gjelbër
- Instrumente ekonomike
- Metoda kërkimore dhe analiza të të dhënave

Viti i dytë

Fokus në aplikime dhe specializim:

- Analiza e zinxhirëve të vlerës
- Modele qarkulluese në sektorë
- Financat e gjelbra
- Menaxhim projektsh

- Teza e Masterit

Programi siguron balancë midis:

- formimit teorik
- aplikimit praktik
- kërkimit shkencor

Qasja ndërdisiplinore

Programi bazohet në parimin e ndërdisiplinaritetit, duke integruar:

Programi integron:

- ekonominë
- politikat publike
- financat
- mjedisin
- teknologjinë

Kjo qasje ndërdisiplinore përbën një nga vlerat kryesore të shtuara të programit Master i Shkencave në Ekonomi Qarkulluese. Programi dallohet për profilin e tij bashkëkohor, praktik dhe të orientuar drejt së ardhmes, veçanërisht përmes:

- Fokusit të qartë të ekonomia qarkulluese si një model transformues që shkon përtej qasjeve tradicionale ekonomike;
- Integritit të politikave të Bashkimit Evropian, Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane dhe tranzicionit të gjellbër në komponentët akademikë dhe praktikë të programit;
- Përgatitjes praktike të studentëve për nevojat e reja të tregut të punës në fushat e qëndrueshmërisë, eficiencës së burimeve, politikave mjedisore dhe zhvillimit të biznesit të gjellbër;
- Lidhjeve të forta me projektet evropiane, instrumentet e financimit dhe mundësitë për bashkëpunim ndërkombëtar;
- Strukturës moderne ndërdisiplinore që ndërthur ekonominë, menaxhimin mjedisor, inovacionin, politikat publike, financën, sipërmarrjen dhe transformimin digjital;
- Orientimit drejt punësueshmërisë, kompetencave profesionale, inovacionit dhe krijimit të mundësive të reja të biznesit të qëndrueshëm;
- Përgatitjes së të diplomuarve që mund të kontribuojnë në procesin e integritit evropian të Shqipërisë dhe në tranzicionin drejt një ekonomie më të gjellbër, më konkurruese dhe më eficiente në përdorimin e burimeve.